



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 179 / Prot.

Tiranë, më 08. 02. 2022

VENDIM

Nr. 26, Datë 08./02/2022

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES SË TRAJNIMEVE NË KLSH

KLSH, ka konsideruar komponentin zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe trajnimit si prioritetin kryesor në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore. Procesi i trajnimit të vazhdueshëm duhet të funksionojë në mënyrë efektive, duke u përmirësuar në vijimësi dhe duke u konsoliduar, me qëllim kthimin në vlerë të shtuar të njohurive të përfituara, drejtpërsëdrejti në rritjen e cilësisë së auditimeve dhe veprimtarisë së KLSH. Kjo rregullore, hartuar edhe në zbatim të Kornizës së Matjes së Performancës (PMF), SAI-23 “Zhvillimi Profesional”, përmban disa udhëzime dhe procedura që duhet të zbatohen, me qëllim përmirësimin e cilësisë së zhvillimit të trajnimeve në KLSH.

Në përgjigje të kërkesave të kohës, me qëllim rritjen e performancës së trajnimeve, referuar ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 25 “Përgjegjësitë”;

VENDOSA:

1. Miratimin e Rregullores së Trajnimeve në KLSH;
2. Ngarkohet për zbatimin e saj, Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit, trajnerët e brendshëm të KLSH, si dhe pjesëmarrësit në trajnime;
3. Ngarkohet për njohjen e stafit me këtë rregullore, Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit;
4. Ngarkohet me publikimin e saj në faqen web të KLSH, në rubrikën “Trajnime të brendshme”, Drejtoria IT në KLSH;
5. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

